

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE DHE I SPORTIT**



PUNIMI I DIPLOMËS – MASTER

Tema

**DALLIMI NË MES FUTBOLLISTËVE PIONIER DHE KADET SIPAS
POZICIONIT NË FUSHË NË DISA KARAKTERISTIKA
ANTROPOMETRIKE DHE AFTËSI MOTORIKE**

MENTORI:
Dr. Asoc. Bylbyl Sokoli

KANDIDATI:
Fisnik Lushtaku
Arton Hajdari

Prishtinë, 2017

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	4
2. QËLLIMI I PUNIMIT	9
3. HPOTEZAT THEMELORE	10
4. METODAT E HULUMTIMIT	11
4.1 PËRKUFIZIMI I MOSTRËS SË HULUMTIMIT	11
4.2 NDRYSHORET ANTROPOMETRIKE	12
4.3 NDRYSHORET MOTORIKE	12
4.4 KUSHTET E MATJES	13
4.5 TEKNIKAT E MATJES	14
4.5.1 Teknika e matjeve të karakteristikave antropometrike	14
4.5.2 Teknika e matjeve të aftësive motorike	26
4.6 METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE	34
5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUSUTIMI	35
5.1. ANALIZA DESKRIPTIVE E NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE	35
5.1.1 Analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike dhe motorike e futbollistëve të sulmit U-15	35
5.1.2 Analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike dhe motorike e futbollistëve mesfushor U-15	40
5.1.3 Analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike dhe motorike e futbollistëve të mbrojtjes U-15	45
5.1.4 Analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike dhe motorike e futbollistëve të sulmit U-17	50
5.1.5 Analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike dhe motorike e futbollistëve mesfushor U-17	55
5.1.6 Analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike dhe motorike e futbollistëve të mbrojtjes U-17	60
5.2 INTERKORELACIONI I NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE	65
5.2.1 Interkorelacioni i ndryshoreve antropometrike te futbollistët e sulmit, mesfushor dhe mbrojtjes U15 dhe U17.....	65

5.2.2 Interkorelacioni i ndryshoreve motorike te futbollistët e sulmit, mesfushor dhe mbrojtjes U15 dhe U17.....	66
5.3 DALLIMI NË MES FUTBOLLISTËVE U15 NË NDRYSHORET ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE.....	67
5.3.1 Dallimi në mes futbollistëve të sulmit dhe mesfushor në ndryshoret antropometrike dhe motorike.....	67
5.3.2 Dallimi në mes futbollistëve të sulmit dhe mbrojtjes në ndryshoret antropometrike dhe motorike.....	68
5.3.3 Dallimi në mes futbollistëve mesfushor dhe mbrojtjes në ndryshoret antropometrike dhe motorike.....	69
5.4 DALLIMI NË MES FUTBOLLISTËVE U17 NË NDRYSHORET ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE.....	70
5.4.1 Dallimi në mes futbollistëve të sulmit dhe mesfushor në ndryshoret antropometrike dhe motorike.....	70
5.4.2 Dallimi në mes futbollistëve të sulmit dhe mbrojtjes në ndryshoret antropometrike dhe motorike.....	71
5.4.3 Dallimi në mes futbollistëve mesfushor dhe mbrojtjes në ndryshoret antropometrike dhe motorike.....	72
5.5 DALLIMI NË MES FUTBOLLISTËVE U15 DHE U17 NË NDRYSHORET ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE.....	73
5.5.1 Dallimi në mes futbollistëve të sulmit U15 dhe U17 në ndryshoret antropometrike dhe motorike.....	73
5.5.2 Dallimi në mes futbollistëve të sulmit U15 dhe U17 në ndryshoret antropometrike dhe motorike.....	74
5.5.3 Dallimi në mes futbollistëve të sulmit U15 dhe U17 në ndryshoret antropometrike dhe motorike.....	75
5.6 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE.....	76
6. PËRFUNDIMI.....	77
7. LITERATURA.....	79
REZYME.....	81
SUMMARY.....	82

1. HYRJE

Njohja e strukturave të disa dimensioneve të statusit psikosomatik të sportistëve (sidomos atij morfologjik), me këte edhe të zhvillimit e tyre*, paraqet kushtin themelor për udhëheqje të drejt me procesin stërvitor. Duke iu falënderuar hulumtimeve të shumta në të cilat janë angazhuar në vërtetimin e strukturës së disa pjesëve të hapësirës psikosomatike, në shkallën e tashme të zhvillimit të shkencës në kulturën fizike, me bindje dhe siguri të plotë mund të flasim mbi ekzistimin e karakteristikave të ndryshme antropometrike si dhe të aftësive dhe veçorivetë ndryshme.

Definimi i konstitucionit të njeriut e sidomos i sportistit është shumë kompleks për shkak të disa faktorëve të cilët në mënyrë direkte ndikojnë në veçoritë morfologjike, fiziologjike, biokimike dhe psikike të tij. Vet reaktioni i organizmit si tërësi në disa ngacmime respektivisht sjellje në situata të ndryshme të jetes dhe punës përbëjnë grupin e të gjitha veçorive morfologjike, fiziologjike, biokimike dhe psikike të cilët japin karakter konstitucionit të njeriut respektivisht paraqet fenotipin** i cili zhvillohet si simbioza e gjenotipit të caktuar i cili është nën ndikimin e faktorëve kompleks të jashtëm. Shumë autorë dukurin apo nocionin e gjenotipit shpesh e kanë identifikuar me konstitucionin trupur. Mirëpo nocioni i konstitucionit është shumë më i gjerë dhe plastik dhe vet mundësia e formimit në kushte të rrethit në të cilën njeriu jeton, nën veprimin e mënyrës së të jetuarit, punës dhe edukimit na orjenton neve që të kuptojmë se në konstitucionin e njeriut ndikim fundamental kanë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të zhvillimit të njeriut.

Kur bëhet fjalë për konstitucionet nuk mundemi që ndarasi të flasemi për tipet e meshkujve dhe të femrave sepse tipet konstitucionale janë të pavarur nga gjinia, dhe se të gjitha llojet e tipeve i hasim te dy gjinit. Gjithashtu nuk ekziston ndaras ose veç konstitucioni e disa moshave sepse fëmija shumë shpejt në zhvillimin e vet ndryshom dhe

* Duke pasur parasysh vëllimin e materies, si dhe heterogjenitetin e strukturës së e disa dimensioneve të personalitetit në disa sporte, zhvillimi i tyre (aplikimi i mjeteve specifike, metodave dhe ngarkesave) duhet të jetë lëmi dhe detyrë e hulumtimit në kuadër ose brenda secilës degë të sportit.

** Fenotipi është tërësi e të gjitha veçorive të një organizmi të cilat janë zhvilluar me veprimin e përbashkët të gjenotipit dhe kushteve të mesit në të cilin ai organizëm është zhvilluar. Nocionin e fenotipit i pari e ka përmend Johannsen në vitin 1909.

më von pas vitit të 10 kemi diferencimin e parë e disa tipeve ashtu që tipin konstitucional definitiv të i rrituri do të formohet pas vitit të 20.

Tek njerzit e moshuar tipet konstitucionale ndryshojnë në rend të parë në drejtim komponentes funksionale. Klasifikimin e disa tipeve konstitucionale mund ta shikojmë me metodën subjektive ku dominon vëzhgimi dhe vlerësimi i disa veçoriv, e metoda tjetër është objektive ku dominon matja e disa veçorive dhe krahasimi i tyre. Më së miri është të shfrytëzohen dy metodat.

Nëse për shembull, e marrim që ta vëzhgojmë konstitucionin trupor vetëm sipas kriteriumeve morfologjike, vijmë në përfundim që ky klasifikim ka dy tipe shumë të kundërt të shprehur, ku në njëren anë mbretrojnë lartësia (parametrat e gjatësisë) dhe te tjetër gjërësia e trupit (transversale). Ekziston edhe tipi mesatar tek i cili nuk ka dominim të asnjëres nga veçoritë morfologjike të dhëna.

Antropometrija (somatometrija) është metodë e matjes e trupit të njeriut, respektivisht të disa pjesëve të trupit, me të cilën në mënyrë kuantitative përcaktohen veçoritë morfologjike dhe shikohet pasqyra objektive e gjendjes dhe zhvillimit të njeriut. Antropologjia antropometrike është metodë e cila përfshinë matjet e trupit të njeriut, përpunimin dhe studimin e matjeve të fituara. Në sporte të ndryshme si ato amatore ashtu edhe kulminante kjo shërben për:

- Seleksionimin e kandidatve për çdo sport
- Përcjelljen dhe evaulimin e procesit stërvitor
- Vlerësimin objektiv e zhvillimit të përgjithshëm të trupit
- Kontrollimit të gjendjes së ushqyeshmërisë së sportistit
- Përcjelljen e çlodhjes së sportistit në procesin e rehabilitimit

Rëndësia e ndërtimit të trupit për sportet kulminante nuk është e definuar në tërësi si parakusht për arritjen e rezultateve kulminante në sportet kulminante. Prap se prap, hulumtimet kanë treguar se sportistët e suksesshëm tregojnë ngjajshmëri në ndërtimin dhe në raportin e masës yndyrore dhe jo yndyrore trupore, dhe këto shprehen më shumë duke përparuar dmth. duke arritur kategori gjithë e më të larta në sportin kulminant. Sipas kësaj,

Në kohën e sotme, niveli i arritjes në sportin kulmor aq është i lartë sa që sportistët gjatë sistemeve të përgatitjes stërvitore mund të arrijnë ose ti tejkalojnë vetëm me anë të

ngritjes më të madhe të efikasitetit stërvitor. Mirëpo, rritja e efikasitetit supozohet, jo vetëm rritja e sasisë së punës, por në rend të parë organizimin më të mirë të procesit stërvitor, zgjedhja më e mirë e mjeteve dhe metodave, renditja më racionale e e punës dhe çlodhjes gjatë një procesi stërvitor, disa proceseve stërvitore, etapave dhe periudhave, dhe e gjithë këjo pndërprer duke u kujdesur për gjendjen e sportistit (Bala, 2007; Bala, 1996); Barišić, 2007). Në kohën e fundit futbolla si sport ekipor paraqet një nga fushat më të rëndësishme në të cilën futbollisti në mënyrë vetanake mund ti shprehë si dhe ti tregojë në mënyrë individuale dhe grupore karakteristikat e tija antropometrike, aftësit e veta bazike motorike dhe situacionale – motorike në lojën e futbollit. Mendohet se njëri ndër motivet kryesore të ushtruarit të lojës së futbollit padyshim është edhe ngritja e cilësive të futbollistëve në arenën ndërkombtare, pastaj organizimin më të mirë të procesit stërvitor, që ai të kuptohet si qëllim i ruajtjes dhe avancimit të shëndetit, dhe ngritjes profesionale të futbollistit (Gjinolli, 1982; Halimi, 2012; Hysaj, 2012; Kryeziu, 2011).

Si në lojërat e tjera sportive apo ekipore sportive, në lojën e futbollit sukcesi varet nga shumë faktorë:

1. Përgatitjes teknike
2. Përgatita taktike dhe vendim-marrjes në lojë
3. Përgatitja fizike
4. Përgatita psikologjike dhe rezistenca mendore
5. Karakteri dhe aftësitë e komunikimit
6. Strategjia dhe plani i lojës

Sipas Elsnerit (1974) “Me karakteristika morfologjike të strukturës të statusit psikosomatik të njeriut nënkuptojmë sistem të caktuar të dimensioneve latente antropometrike pa marr parasysh atë se, a janë zhvilluar këto dimensionë nën ndikimin e vaçant të rrethit të jashtëm (me trajning të caktuar apo jo)”. Në pajtim me këte, që të vërtetohen në mënyrë shkencore dimensionet latente të kësaj hapsire, zgjidhja është mbështetur në aplikimin e analizës faktoriale dhe analizës diskriminative. Sipas Elsnerit janë izoluar faktorët morfologjik të cilat janë definuar si dimensione latente (nga seria e variablave manifeste), dhe të cilat janë përgjegjëse për kovariabilitetin e gjendjeve të ndryshme manifeste dhe reaksioneve në atë hapësirë. Para se gjithash, analiza

faktoriale mundëson të hyjmë në esencë të strukturës morfologjike dhe dimensioneve të tjera të statusit psikosomatik të njeriut duke zbuluar dimensione latente, të cilat janë përgjegjëse për manifestimet e jashtme të dukurive konkrete.

Aftësitë motorike dhe funksionale janë parakushte të domosdoshme për çdo lloj të lëvizjes së njeriut e për këte edhe për çdo aktivitet kineziologjik ose aktivitet sportiv. Kohëgjatësia, intensiteti, dhe numri i përsëritjeve i strukturave të ndryshme lëvizore, përcaktojnë rëndësinë e disa aftësive kondicionale. Është e njohur që sa më i ndërlikuar të jetë aktiviteti sportiv sipas strukturës së lëvizjes tek ajo paraqitet numër më i madh i aftësive të ndryshme motorike dhe funksionale.

Suksesi në lojën e futbollit mvaret prej karakteristikave antropometrike dhe aftësive specifike të cilët udhëheqin me lojën si dhe ekzekutimi i elementeve teknike në sportet ekipore, konkretisht në lojën e futbollit kërkon nivel të caktuar të përgaditjes dhe strukturën e aftësive bazike motorike dhe funksionale . Kështu për shembull, aftësia e shpejtësisë dhe e forcës japin mundësi më të mëdha të suksesit në lojën e futbollit, më konkretisht thënë, lëvizshmëria e ekstremiteteve të poshtme mundëson plasimin e goditjeve precize. Në vazhdim, përgaditja e mirë fizike dhe teknike ndikon në realizimin e detyrave të caktuar në sulm dhe në mbrojtje.

Gjatë lojës numri më i madhë i aftësive motorike në proceset e aktiviteteve komplekse kineziologjike, në rastin konkret në lojën e futbollit, e sidomos gjatë lojës, më së tepërmi varën nga procesi i pranimit, bartjes, mbajtjes dhe përpunimit si dhe përcjelljes me rrugë eferente deri te efektorët. Lidhmëria e këtyre elementeve si dhe elementeve tjera antropologjike kërkon nga njeriu që ai të trajtohet si sistem kibernetik.

Që të mund të vlerësohet dhe matet ndonjë aksion i njeriut në hapësirën psikomotorike dhe lidhshmërin e saj me karakteristikat tjera antropologjike është e domosdoshme që këtë strukturë ta identifikojmë. Gjithmon është e natyrës që paramatrat antropologjik, domethënë, karakteristikat morfologjike pastaj aftësitë psikomotorike së bashku me aftësitë teknike dhe karakteristikat e elementeve taktike si dhe veçorit konative dhe aftësitë kognitive si dhe ato sociale tek futbollistët duhet të jenë në ndonjë ndërlidhje të caktuar. Niveli dhe vlerat e këtyre raporteve dhe lidhjeve gjerë më tani nukë janë hulumtuar në nivelin e kënaqshëm.

Efikasiteti i zgjedhjes së teknikave të mësuara është e kushtëzuar me aftësitë e caktuara kondicionale dhe në anën tjetër me

aftësitë e futbollistit për pranimin, përpunimin dhe shfrytëzimit të informacioneve taktike, vendosshmërinë e tij dhe shpejtësinë së gjetjes së zgjidhjeve në problemet taktike të cilat lajmërohen në lojë (Aubrecht me bp.,1983).

Karakteristikat optimale morfologjike të futbollistëve në të shumtën dhe në masë të madhe varen nga lloji i sportit, por marr në përgjithësi rezultate më të mira arrijnë ata futbollistë ndërtimi trupor i të cilëve më tepër është i përshtatur kërkesave të sportit konkret, në këtë rast lojës së futbollit. Nevoja për përshtatje të tillë është më e theksuar si është asportisti apo futbollisti në një nivel më të lartë të garës (Stojanović me bp.,1975).

Suksesi në sport gjithsesi varet nga karakteristikat morfologjike të futbollistëve, nga të cilat më kryesoret janë lartësia dhe pasha e trupit si dhe masa muskulore e këmbëve ose perimetri i kofshës dhe kërcirit, të cilat valorizohen duke marrë parasysh moshën aktuale të sportistëve (Gabrijelić, 1972; Gabrijeli, 1982; Gabrijelić, me bp.,1983). Kjo që u theksua më lartë është shumë e rëndësishme që të respektohet gjatë rritjes dhe zhvillimit të sportistëve, kur mosha kronologjike dhe biologjike shpesh nuk janë në harmoni, e kjo është zakonisht periudha kur profilizohen sportistët e ardhshëm kulmor (Malina me bp., 2004.; Mišigoj - Duraković, 2008). Duke marr parasysh kërkesat e çdo sporti, përcaktohet periudha e jetës kur pritet të arrihen rezultatet më të mëdha sportive.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Lojës e futbollit sot kuptohet si lojë moderne-bashkëkohore e cila kërkon plotësimin e faktorit të kohës dhe hapësirës, shtyjnë në kërkimin e cilësive të larta individuale tekniko-taktike të futbollistëve për të kryer detyrat kolektive që i obligon loja.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të vërtetohet dallimi te futbollistët (U-15) në disa karakteristika antropometrik dhe aftësi motorike dhe te futbollistët te futbollistët (U-17) disa karakteristika antropometrik dhe aftësi motorike si dhe të përcaktohet dallimi në mes futbollistëve pionier U15 dhe futbollistëve kadet (U – 17) të KF. Feronikeli në Drenas dhe KF. Drenica në Skenderaj.

Qëllimi dytësor i punimit është:

- Vlersimi i karakteristikave antropometrike dhe motorike te futbollistët pionier dhe kadet të ndarë sipas pozicioneve në fushë.
- Lidhmëria ndërmjet karakteristikave antropometrike dhe motorike.
- Dallimet në karakteristikat antropometri në mes tri grupeve të trajtuara .
- Dallimet në aftësitë motorike në mes tri grupeve të trajtuara .

3. HPOTEZAT THEMELORE

Duke u mbështetur në qëllimin e këtij punimi janë parashtruar këto hipoteza :

Hipoteza 1. Pritet se karakteristikat antropometrike dhe aftësit bazike-motorike nuk do të kenë asimetri të theksuar të rezultateve.

Hipoteza 2. Pritet se do të ketë korelacione të rëndësishme ndërmjet veti karakteristikave antropometrike dhe aftësive motorike

Hipoteza 3. Pritet se do të paraqiten dallime të rëndësishme statistikore ndërmjet futbollistëve U15 dhe U17, të ndarë në tri grupe sipas pozicionit në lojë në karakteristikat antropometrike është realizuar pjesërisht

Hipoteza 4. Pritet se do të paraqiten dallime të rëndësishme statistikore ndërmjet futbollistëve U15 dhe U17, të ndarë në tri grupe sipas pozicionit në lojë në aftësitë motorike.

Hipoteza 5. Pritet që do të ketë dallime në mes futbollistëve U15 dhe U17, të ndarë sipas pozicionit në lojë në karakteristikave antropometrike dhe motorike të.

4. METODAT E HULUMTIMIT

4.1 PËRKUFIZIMI I MOSTRËS SË HULUMTIMIT

Mostrën në këtë hulumtim e kanë përbërë futbollistët të ndarë në dy grupe, 105 futbollistëve pionier (U-15) dhe 105 futbollistëve kadet (U-17) të KF.Feronikeli në Drenas dhe KF.Drenica në Skenderaj.

Mostrën në këtë hulumtim, 105 futbollistë pionier (U-15) dhe 105 futbollistë kadet (U-17) janë ndarë në tri grupe sipas pozicionit që e kanë në lojë, edhe atë 35 futbollist të sulmit, 35 futbollist mesfushor dhe 35 futbollist të mbrojtjes gjithsej 105 futbollistëve pionier (U-15) edhe 35 futbollist të sulmit, 35 futbollist mesfushor dhe 35 futbollist të mbrojtjes gjithsej 105 futbollistëve kadet (U-17),

Të testuarit (futbollistët-pionier dhe kadet) në këtë hulumtim vullnetarisht kanë shpreh dëshirën për pjesëmarrjen e tyre në hulumtim dhe kanë marr miratimin e prindërve dhe trajnerëve të tyre.

4.2 NDRYSHORET ANTROPOMETRIKE

Në këtë hulumtim janë përfshirë 12 ndryshore antropometrike

1. **ALARTE** - Lartësia e trupit
2. **APESHA** - Pesha e trupit.
3. **APERGJ** - Perimetri i gjoksit
4. **APERAB** - Perimetri i abdomenit
5. **APERKR** - Perimetri i krahut
6. **APERKO** - Perimetri i kofshës.
7. **APERKE** - Perimetri i kërcirit
8. **AIDHKR** – Indi dhjamor i krahut
9. **AIDHSH** – Indi dhjamor i shpinës
10. **AIDHBA** – Indi dhjamor i barkut
11. **AIDHKO** – Indi dhjamor i kofshës
12. **IDHKR** – Indi dhjamor i kërcirit

4.3 NDRYSHORET MOTORIKE

Në këtë hulumtim janë përfshirë 8 ndryshore motorike

1. **MV20L** – Vrapim 20 m starti i lartë
2. **MKGJV** – Kërcim nga vendi në gjatësi
3. **MKLAV** – Kërcimi nga vendi në lartësi
4. **MTDOR** – Tapingu me dorë
5. **MTKËM** – Tapingu me këmbë
6. **MTPËR** – Ngritja e trupit (barkushet)
7. **MHANA** – Hapa anash
8. **MFPPA** – Fleksibiliteti për kulje para

4.4 KUSHTET E MATJES

1. Matjet antropometrike janë ekzekutuar në orët e para të pasdites.
2. Instrumentet matëse kanë qenë të punimit standard dhe kanë qenë të bazhduara së paku çdo ditë para matjeve.
3. Vendi ku janë ekzekutuar matjet ka qenë hapësira e mjaftueshme dhe e ndriçuar mirë, ndërsa temperatura e ajrit rreth 22°.
4. Në vendin ku janë ekzekutuar matjet (sallë e edukatës fizike) kanë qenë pesë matës, shkruesi i rezultateve dhe grupi prej pesë të testuarve (secili matës nga një të testuar të cilët janë zëvendësuar pas matjes).
5. Të testuarit para matjes kanë qenë zbathur dhe vetëm në brekë.
6. Në çdo të testuar, para matjes, janë përcaktuar dhe shënuar në mënyrë të saktë nivelet dhe pikat antropometrike të cilat kanë qenë në programin e matjeve.
7. Dimensionet e caktuara antropometrike çdo herë i ka matur i njëjti matës.
8. Rezultatet e matjes janë lexuar gjatë kohës deri sa testuesi ka matur, ndërsa personi cili i ka shkruar rezultatet, për ti kontrolluar i ka përsëritur rezultatet me zë të çartë.
9. Matjet e ekstremiteteve çift të trupit janë ekzekutuar në anën e majtë të trupit.
10. Matjet antropometrike janë përsëritu nga tri herë.

4.5 TEKNIKAT E MATJES

4.5.1 Teknika e matjeve të karakteristikave antropometrike

Variablat antropometrike* janë matur sipas mënyrës siç vijon:

1. Lartësia e trupit (ALARTE) është matë me antropometër sipas Martinit. Gjatë matjes i testuari është i zbathur në brekë dhe qëndron në drejtpërdrejt në bazën e rrafshët të antropometrit. Koka e të testuarit duhet të jetë në aso pozite që drejtëza e Frankfurtit të jetë horizontale. I testuari drejton shpinën aq sa është e mundur, dhe shputat i ka të bashkuara. Testuesi qëndron nga ana e majtë dhe kontrollon se akrepi i antropometrit a është vendosur vertikalisht në mënyrë të drejtë drejtpërdrejt përgjatë pjesës së mbrapse të trupit të testuarit dhe pastaj, lëshon unazën metalike (rrëshqitësin) ashtu që akrepi horizontal të vendoset në mënyrë të drejtë në majën e kokës. Atëherë lexohet rezultati në shkallën e matjes të antropometrit me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 1. Lartësia e trupit



* Të gjitha matjet janë ekzekutuar sipas metodës të cilën e ka propozuar IPB (International Biologic Program) Programi biologjik ndërkombëtar. PBN (Programi biologjik ndërkombëtar) ka përgatitur listën e matjeve antropometrike duke e pasur parasysh nevojën e atyre që merren me hulumtime të karakteristikave të trupit të njeriut në kushte të ndryshme e që shpesh nuk janë antropolog. Nga lista e matjeve antropologjike të propozuara nga Programi biologjik ndërkombëtar, gjithsejtë 39 matje, për nevojat e këtij hulumtimi janë përdorur 12 matje antropometrike (nga tri matje të çdo dimensionit morfologjik. Parametrat e treguesve antropometrik maten sipas procedurës të cilat i kanë (në bazë të propozimit të autorit Stoudt dhe Mc Farlanta) përpunue M.Stojanoviç i Z.Stojkovië.

2. Peshë e trupit (APESHA) është matë me peshore transportabile të vendosur në sipërfaqe të rrafshët. I testuari, zbathur dhe në brekë vendoset në mesin e peshores dhe qëndron në drejtqëndrim. Atëherë kur akrepi në peshore nuk lëvizë, rezultati lexohet me saktësi prej 0,5 kg.

Foto 2. Peshë e trupit



3. Perimetri i gjoksit (APERGJ) është matë me traken matëse plastike. Para matjes i testuari është i zbathur, në brekë dhe qëndron në drejtpëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Traka matëse mbështjellët rreth gjoksit në një pozitë horizontale ndaj boshtit të trupit, duke kaluar horizontalisht nëpër pikat e lidhjes së brinjëve 3. dhe 4. për kockën e gjoksit. Rezultat i matjes lexohet atëherë kur kafazi i kraharorit është në pozitë mesatare (në fund të ekspiriumit normal, respektivisht, në pauzë ndërmjet inspirimit dhe ekspirimit). Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 3. Perimetri i gjoksit



4. Perimetri i abdomenit (APERAB) është matë me traken matëse plastike. Para matjes i testuari është i zbathur, në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Traka matëse mbështjellët rreth gbelit në një pozitë horizontale ndaj boshtit të trupit, duke kaluar horizontalisht nën brinjë . për kockën e gjoksit. Rezultat i matjes lexohet atëherë kur kafazi i kraharorit është në pozitë mesatare (në fund të ekspiriumit normal, respektivisht, në pauzë ndërmjet inspirimit dhe ekspirimit). Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 4. Perimetri i abdomenit



5. Perimetri i krahut (APERKR) është matë me traken matëse prej plastike. Para matjes i testuari është i zbathur dhe në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Traka matëse mbështjellët rreth krahut të majtë (pjesës më të trashë) në boshtin e tij në nivel i cili i përgjigjet mesit ndërmjet akromionit dhe olekranonit. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 5. Perimetri i krahut



6. Perimetri i kofshës (APERKO) është matur me shirit milimetrik. I maturi qëndron në këmbë me gjymtyrë të poshtme diç të larguara. Shiriti vendoset në të tretën e sipërme të kofshës (gjerësia më e madhe). Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

Foto 6. Perimetri i kofshës




7. Perimetri i nëngjurit në drejtqëndrim – kërcirit (APERKE) është matë me traken matëse gjysmë plastike. Para matjes i testuari është i zbatshur dhe në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim. Traka matëse mbështjellët rreth pjesës së nëngjurit të majtë (pjesës më të trashë) në boshtin e tij në nivel i cili i përgjigjet mesit ndërmjet zogut të këmbës dhe pjesës së eperme të tibies. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 7. Perimetri i nëngjurit - kërcirit



8. Indi dhjamor nën lëkuror i krahut (AIDHKR) është matë me kaliper “John Bull” i rregulluar ashtu që shtypja e skajeve të krahëve të kaliperit në lëkur të jetë 10gr/mm². Para matjes i testuari është i zbathur, në brekë qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë vërtikalisht kap lëkurën drejtpërdrejt në pjesën e mbrapme të krahut të majtë (tek muskuli triceps) në vendin e cila i përgjigjet mesit ndërmjet akromionit dhe olekranonit, duke patur kujdes që most ë kapet indi muskolor, kap palën (rrudhën) e lëkurës me majet e akrepave të kaliperit (të vendosur më poshtë se majet e gishtrinjëve. Rezultatet lexohen me saktësi prej 0,2 mm.

Foto 8. Indi dhjamor nën lëkuror i krahut (AIDHK)



9. Indi dhjamor nën lëkuror i shpinës (AIDHSH) (nën këndin e poshtëm të shpatullës) është matë me kaliper “John Bull” i rregulluar ashtu që shtypja e skajeve të krahëve të kaliperit në lëkur të jetë 10gr/mm². Para matjes i testuari është i zbathur dhe në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë horizontalisht kap lëkurën drejtpërdrejt nën këndin e poshtëm të shpatullës së majtë, duke pasur kujdes që të mos kap indin muskolor, kap palën (rrudhën) e lëkurës me majat e akrepave të kaliperit. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,2 mm.

Foto 9. Indi dhjamor nën lëkuror i shpinës(AIDSH



10. Indi dhjamos i abdomenit AIDHAB është matë me kaliper “John Bull” i rregulluar ashtu që shtypja e skajeve të krahve të kaliperit në lëkur të jetë 10gr/mm². Para matjes i testuari është i zbathur, në brek dhe qëndron në drejtëqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë dhe relaksim të muskujve të barkut. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë horizontalisht kap lëkurën në anën e majtë të barkut në nivel të kërthizës (ombilikusit) dhe 5 cm në të majtë nga ai, duke patur kujdes që të mos kap edhe inde muskulore , kap palën (rrudhën) me majet e akrepave të kaliperit(të vendosur medialisht nga majet e gishtrinjëve). Rezultati lexohet me saktësi prej 0,2 mm.

10. Indi dhjamos nën lëkuror i barkut AIDHB



11. Indi dhjamor nën lëkuror i kofshës (AIDHKO) është matë me kaliper “John Bull” i rregulluar ashtu që shtypja e skajeve të krahëve të kaliperit në lëkur të jetë 10gr/mm². Para matjes i testuari është i zbathur, në brekë qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë vërtikalisht kap lëkurën drejtpërdrejt në pjesën e mbrapme të këmbës së majtë (tek muskuli biceps) në vendin e cila i përgjigjet mesit, duke patur kujdes që most ë kapet indi muskolor, kap palën (rrudhën) e lëkurës me majet e akrepave të kaliperit (të vendosur më poshtë se majet e gishtrinjëve. Rezultatet lexohen me saktësi prej 0,2 mm.

11. Indi dhjamor nën lëkuror i barkut AIDHB



12 Indi dhjamos nën lëkuror i nëngjirit –kërcirit (A IDHKR) është matë me kaliper “John Bull” i rregulluar ashtu që shtypja e skajeve të krahëve të kaliperit në lëkur të jetë 10gr/mm². Para matjes i testuari është i zbathur, në brekë qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë vërtikalisht kap lëkurën drejtpërdrejt në pjesën e mbrapme nga jashtë të nëngjirit të majtë (tek muskuli triceps), duke pasur kujdes që most e kapet indi muskolor, kap palën (rrudhën) e lëkurës me majet e akrepave të kaliperit (të vendosur më poshtë se majet e gishtrinjëve. Rezultatet lexohen me saktësi prej 0,2 mm.

12. Indi dhjamos nën lëkuror i kërcirit



4.5.2 Teknika e matjeve të aftësive motorike

Variablat motorike janë ekzekutuar sipas mënyrës siç vijon:

1. Vrapim 20 metra nga starti i lartë – MV20L

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari me shpejtësi maksimale vrapon gjatësinë e shtegut 20m.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e caktuar. Koha matet në saktësi 1/10 sek.

Udhëzime të testuarës: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. I testuari udhëzohet që pas arritjes në vijën e caktuar të vazhdojë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

13. vrapim 20 metra nga starti i lartë



2. Kërcim nga vendi në gjatësi – MKGJAV

Instrumentet: Dysheku i gjimnastikës dhe metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron e kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejtë-qëndrimi me këmbë të kthyer në gjunjë që mundëson kërcim më të suksesshëm.

Realizimi i detyrës: I testuari kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

14. Kërcim së gjati nga vendi



3. Kërcim nga vendi në lartësi – MKLAV

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari vendoset brinjazi pranë murit Shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit.

Realizimi i detyrës: I testuari e ngritë dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë , e testuara kërcen vertikalisht në lartësi (tre tentime). Lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: Lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Udhëzime të testuarës: I testuari udhëzohet gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. E testuara bënë disa tentime provuese.

15. Kërcim së larti nga vendi



4. Tapingu me këmbë – MTKËM

Instrumentet: Dysheku i gjimnastikës i kufizuar në dimensionet 40 X 40 cm me lartësi 36cm., kronometri me 1/10 sek.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari ka qëndruar e kthyer me fytyrë kah muri, ku është i shënuar katrori. Pas disa tentimeve provuese, e testuara e ka zgjedhë largësinë e duhur nga katrori i shënuar.

Realizimi i detyrës: Detyra e të testuarës ishte që brenda 15 sek., sa më shpejtë që është e mundur, pa ndërprerje me një rën pastaj këmbën tjetër, të bëjë takime-goditje të dyfishta me pjesën e përparme të shputës. Testi përsëritet tri herë, me pushime të mjaftuara ndërmjet tyre.

Vlerësimi: Llogaritet numri i goditjeve të rregullta me shputë në katrorin e shënuar në kohëzgjatje prej 15 sek.

Udhëzime të testuarës: I testuari udhëzohet gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra, (i tregohet ngadalë, për goditjet e rregullta dhe ato të parregullta). E testuara bënë disa tentime provuese.

16. Tapingu me këmbë



5. Tapingu me dorë – MTDOR

Instrumentet: Banka, karriga, dy pllaka nga letra e trashë me diametër 20cm në largësi 61 cm nga njëri-tjetri (skajet e brendshme), shirit ngjitës të dukshëm dhe kronometri.

Përshkrimi i detyrës:


Pozita fillestare: I testuari ka qëndruar e kthyer me fytyrë kah matësi i kohës, ku ka qëndruar e ulur në karrige me duar të vendosura mbi bankë (njëra dorë në mes kurse tjetra në pllakën e djathtë). Pas disa tentimeve provuese, e testuara e ka zgjedhë largësinë e duhur nga banka.

Realizimi i detyrës: I testuari qëndron e ulur në karrige dhe vendosë dorën më të dobët në bankë në mes të dy rathëve, ndërsa dorën tjetër e vendosë mbi pllakë. Detyra është që sa më shpejt ta takoj njërën, pastaj pllakën tjetër, në kohë prej 15 sekondash nga momenti i dhënies së komandës “tash”.

Vlerësimi: Shënohen të gjitha prekjet e rregullta të cilat matësi i numëron brenda 15 sek. Llogaritet çdo takim i dy pllakave (një cikël).

Udhëzime të testuarës: I testuari udhëzohet gjatë demonstrimit të detyrës.

17. Tapingu me dorë



6. Ngritja e trupit – MNGRT

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari ka pozitë të shtrirë në shpinë me duar në qafë dhe këmbë të thyera të mbështetura nga treneri

Realizimi i detyrës: Detyra e të testuarit është që brenda 30 sec., sa më shpejt që është e mundur, pa ndërprerje ta ngris trupin.

Vlerësimi: Llogaritet numri i ngritjeve të rregullta në kohëzgjatje prej 30 sec.

Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet iu open gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra, (u tregohet ngadalë, për ngritjet e rregullta dhe ato të parregullta). I testuari bënë disa tentime provuese.

18. Ngritja e trupit-barkushe



7. Hapa anash – MHANA

Instrumentet: Kronometri, shirit ngjitës me ngjyrë të dallueshme. Dy pjesë të shiritit të ngjitësit me gjatësi 0.5 m vendosen në dysheme në largësi 4 m paralel njëra me tjetrën.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron afër vijës së nisjes me këmbë të bashkuara, e kthyer tërthorazi me vijën (drejtimin e lëvizjes).

Realizimi i detyrës: I testuari në shenjën “tash” nis me shpejtësinë më të madhe të mundshme lëvizë me hapa-anash, duke mos i kryqëzuar këmbët, deri te vija tjetër, dhe kthehet në anën tjetër duke mos e ndërruar pozitën e trupit. Subjekti duhet që largësinë 4m ta kalojë 6 herë.

Vlerësimi: Kronometri ndalet kur subjekti me njërin këmbë arrin te vija e nisjes. Rezultati shënohet në saktësi prej 1/10 sek.

Udhëzime të testuarës: I testuari udhëzimet i mer gjatë demonstrimit të detyrës

19. Hapa anash



8. Fleksibiliteti në bankë (përkulje para) – MFPPA

Instrumentet: Banak, metri milimetrikë i plastikës e përforcuar për dërrase të gjatë 80 cm dhe të gjerë 10 cm.

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** I testuari qëndron mbi ulësen suedeze, me këmbët drejtë, në përkulje të thellë të trupit dhe me fytyrë nga drejtimi i përkuljes.

- **Realizimi i detyrës:** I e testuari në përkulje të thellë dhe këmbët drejtë, në maje të gishtërinjve të të dy shuplakave të cilat janë paralelisht njëra me tjetrën, të prekin sa më thellë metrin. Detyra përsëritet dy herë. E testuara e mbanë pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë.

- **Vlerësimi:** Shënohet rezultati i përkuljes më të thellë i shënuar me centimetra. Pika zero është në maje të centimetrave, saktësia e matjes 0,5 cm.

- **Udhëzime të testuarës:** I testuari merr udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. I tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.

20. Përkulje para



4.6 METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Sipas qëllimit të parashtruar dhe hipotezave të përpiluara aplikohen parametrat statistikore dhe metodat kuantitative të cilat vërtetojnë synimet dhe objektivat e këtij punimi. Duke marrë parasysh të gjitha këto fakte, për qëllimet e këtij hulumtimi do të zgjidhen procedurat për të cilat konsiderohet se korrespondojnë me natyrën e problemeve që hulumtohen.

Për çdo ndryshore antropometrike të volumit trupor, ndryshore motorike të forcës eksplozive dhe teste situacionale janë llogariten vlerat e mëposhtme:

1. Parametrat qendrore themelor dhe të shpërndarjes:

- Mesatarja aritmetikore (Ma)
- Devijimi standard (Ds)
- Vlera minimale (Min)
- Vlera maksimale (Max)

2. Lakorja e shpërndarjes ose e shpërndarjes është testuar me anë të koeficientit të asimetrisë „skjunis”, dhe shkalla e lakimit e majës së kurbës "kurtozis".

3. Raportet e ndërlidhjeve ndërmjet ndryshoreve antropometrike dhe testeve motorike në hapësirën manifeste, është realizuar me anë të korelacionit sipas Pearsonit.

4. Për përcaktimin e ndryshoreve antropometrike dhe motorike në mes grupeve apo ekipeve është aplikuar analiza t- tesi për ndryshore të pavarura (Independent Samples Test).

5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUSUTIMI

5.1. ANALIZA DESKRIPTIVE E NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE

5.1.1 Analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike dhe motorike e futbollistëve të sulmit U-15

Në tabelën 1 janë të paraqitura parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike te furbollistët e sulmit. Në këtë tabelë janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – anim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet).

Në tabelën 1. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike te futbollistët e sulmit. U-15

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
ALARTE	35	146.70	171.10	160.2429	4.42621	-.480	1.984
APESHA	35	45.50	81.00	59.6203	7.18323	.524	1.081
APERGJ	35	73.20	95.40	79.3629	5.75454	1.623	1.479
APERAB	35	56.20	78.40	62.2029	5.67085	1.679	1.749
APERKR	35	23.10	30.00	26.1000	1.63851	.127	-.138
APERKO	35	40.60	58.70	48.7029	3.72373	1.062	1.174
APERKE	35	30.50	39.10	34.3143	1.84696	.082	.382
AIDHKR	35	4.20	11.70	6.0543	2.00167	1.531	1.435
AIDHSH	35	4.00	11.80	7.0543	2.39083	.718	-.547
AIDHAB	35	4.80	18.20	8.6343	4.13073	1.308	.391
AIDHKO	35	4.20	17.00	8.5143	3.15410	.949	.678
AIDHKR	35	6.80	17.50	10.7829	2.92751	.897	.063
MV20L	35	3.01	4.16	3.3617	.19558	1.744	7.422
MKGJV	35	194.00	252.00	221.4286	13.68401	.174	-.372
MKLAV	35	39.00	65.00	46.3971	5.67380	1.302	2.306
MTKËM	35	17.00	29.00	22.2000	3.12297	-.006	-.758
MTDOR	35	26.00	42.00	36.0571	3.22621	-.729	1.244
MNGRT	35	15.00	45.00	27.7714	4.98283	.988	4.070
MHANA	35	7.06	10.66	8.3833	.87725	.736	.202
MFPPA	35	28.50	49.10	42.8714	4.84395	-1.329	1.480

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, lartësia e trupit (ALARTË) është 160.24 cm. Rezultati minimal (146.70 cm) dhe ai maksimal (171.10 cm) i ndryshorës lartësia e

trupit tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se testi i asimetrisë dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, pesha e trupit (APESHA) është 59.62 kg. Rezultati minimal (45.50 kg) dhe ai maksimal (81.00 kg) i ndryshorës pesha e trupit tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik. Edhe pse ekziston dallimi në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, rezultatet tregojn se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, perimetri i gjoksit (APERGJ) është 79.36 cm. Rezultati minimal (73.20 cm) dhe ai maksimal (95.40 cm) i ndryshorës perimetri i gjoksit tregon për një dallim të theksuar në mes nxënësve të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik. Ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, çka tregon se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregon për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, perimetri i abdomenit (APERAB) është 62.20 cm. Rezultati minimal (56.20 cm) dhe ai maksimal (78.40 cm) i ndryshorës perimetri i abdomenit tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik. Ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal dhe shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregon për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, perimetri i krahut (APERKR) është 26.01 cm. Rezultati minimal (23.10 cm) dhe ai maksimal (30.00 cm) i ndryshorës perimetri i krahut tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregon për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, perimetri i kofshës (APERKO) është 48.70 cm. Rezultati minimal (40.60 cm) dhe ai maksimal (58.70 cm) i ndryshorës perimetri i kofshës tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të kësaj moshe në këtë

parametër antropometrik. Ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal dhe shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregon për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, perimetri i kërcirit (APERKE) është 34.31 cm. Rezultati minimal (30.50 cm) dhe ai maksimal (39.10 cm) i ndryshorës perimetri i kërcirit tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të sulmit të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik. Rezultatet tregojnë se edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregon për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, indi dhjamor nënlekurore i krahut (AIDHKR) është 6.05 mm. Rezultati minimal (4.20 mm) dhe ai maksimal (11.70 mm) i ndryshorës indi dhjamor nënlekurore i krahut tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të sulmit të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik. Rezultatet tregojnë se ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, dhe shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregon për një asimetri të theksuar

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, indi dhjamor nënlekurore i shpinës (AIDHSH) është 7.05 mm. Rezultati minimal (4.00 mm) dhe ai maksimal (11.80 mm) i ndryshorës indi dhjamor nënlekurore i shpinës tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të sulmit të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik. Rezultatet tregojnë se edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregon për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, indi dhjamor nënlekurore i abdomenit (AIDHAB) është 8.63 mm. Rezultati minimal (4.80 mm) dhe ai maksimal (18.20 mm) i ndryshorës indi dhjamor nënlekurore i abdomenit tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të sulmit të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik. Rezultatet tregojnë se ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, dhe shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregon për një asimetri të theksuar

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, indi dhjamor nënlëkuror i kofshës (AIDHKO) është 8.51 mm. Rezultati minimal (4.200 mm) dhe ai maksimal (17.00 mm) i ndryshorës indi dhjamor nënlëkuror i kofshës tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të sulmit të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik. Rezultatet tregojnë se edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregon për një asimetri të theksuar

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, indi dhjamor nënlëkuror i kërcirit (AIDHKR) është 10.78 mm. Rezultati minimal (6.80 mm) dhe ai maksimal (17.50 mm) i ndryshorës indi dhjamor nënlëkuror i kërcirit tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të sulmit të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik. Rezultatet tregojnë se edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, rezultatet tregojnë se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregon për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores motorike, Vrapim 20 m starti i lartë (MV20L) është 3.36 sek. Rezultati minimal (3.01 sek) dhe ai maksimal (4.16 sek) i ndryshorës Vrapim 20 m starti i lartë flasin për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të kësaj moshe në këtë parametër motorik. Dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal tregon se testi i asimetrisë dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores motorike, Kërcim nga vendi në gjatësi (MKGJV) është 221.00 cm. Rezultati minimal (194.00 cm) dhe ai maksimal (252.00 cm) i ndryshorës Kërcim nga vendi në gjatësi flasin për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të kësaj moshe në këtë parametër motorik. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se testi i asimetrisë dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores motorike, Kërcimi nga vendi në lartësi (MKLAV) është 46.39 cm. Rezultati minimal (39.00 cm) dhe ai maksimal (65.00 cm) i ndryshorës Kërcim nga vendi në lartësi flasin për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të kësaj moshe në këtë parametër motorik. Dallim i theksuara në mes

rezultatit maksimal dhe atij minimal tregon testi i asimetrisë dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores motorike, Taping me këmbë (MTKEM) është 22.20. Rezultati minimal (17.00) dhe ai maksimal (29.00) i ndryshorës Taping me këmbë flasin për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të kësaj moshe në këtë parametër motorik. Edhe pse ekziston dallimi i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, tregon se testi i asimetrisë dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores motorike, Taping me dorë (MDOR) është 36.05. Rezultati minimal (36.00) dhe ai maksimal (42.00) i ndryshorës Taping me dorë flasin për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të kësaj moshe në këtë parametër motorik. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, testi i asimetrisë dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri të theksuar

Mesatarja aritmetikore e ndryshores motorike, Ngritja e trupit (barkushet) (MNGRT) është 27.77. Rezultati minimal (15.00) dhe ai maksimal (45.00) i ndryshorës Ngritja e trupit (barkushet) flasin për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të kësaj moshe në këtë parametër motorik. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, testi i asimetrisë dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri të theksuar

Mesatarja aritmetikore e ndryshores motorike, Hapa anash (MHANA) është 8.38 sek. Rezultati minimal (7.106 sek) dhe ai maksimal (10.66 sek) i ndryshorës Hapa anash flasin për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të kësaj moshe në këtë parametër motorik. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se testi i asimetrisë dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri të theksuar.

. Mesatarja aritmetikore e ndryshores motorike, Fleksibiliteti për kulje para (MFPPA) është 42.87 cm. Rezultati minimal (28.50 cm) dhe ai maksimal (49.10 cm) i ndryshorës Fleksibiliteti për kulje para flasin për një dallim të theksuar dhe testi i asimetrisë dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri të theksuar.

5.1.2 Analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike dhe motorike e futbollistëve mesfushor U-15

Në tabelën 2 janë të paraqitura parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike te furbollistët mesfushor. Në këtë tabelë janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – anim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet).

Në tabelën2. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike te futbollistët mesfushor U-15

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
ALARTE	35	143.20	165.00	157.5343	4.68778	-.863	1.622
APESHA	35	44.40	68.50	56.6514	5.83485	-.091	-.155
APERGJ	35	71.90	89.70	77.4714	3.11897	1.561	5.982
APERAB	35	54.90	72.10	60.0829	3.12396	1.545	5.481
APERKR	35	23.10	28.20	25.5857	1.34518	.516	-.202
APERKO	35	40.60	55.20	47.9486	2.79247	.820	2.321
APERKE	35	30.50	37.20	34.1286	1.49992	-.405	.243
AIDHKR	35	4.20	12.80	6.4771	2.49318	1.679	1.914
AIDHSH	35	4.00	10.60	6.5571	1.65339	.639	.472
AIDHAB	35	4.80	17.40	8.0057	3.45951	1.847	2.759
AIDHKO	35	4.20	12.40	8.4029	2.14743	-.006	-.093
AIDHK	35	4.80	17.50	10.1714	2.47916	.626	1.371
MV20L	35	3.29	3.86	3.5057	.14145	.579	.627
MKGJV	35	180.00	235.00	214.7714	14.41830	-.708	.282
MKLAV	35	34.00	57.20	44.7257	5.33685	.142	.411
MTKËM	35	15.00	28.00	20.2571	2.92397	.711	1.330
MTDOR	35	26.00	39.00	34.5143	3.58404	-.574	-.264
MNGRT	35	15.00	30.00	25.5143	3.95840	-1.031	.834
MHANA	35	7.19	10.97	8.7086	1.02456	1.078	.456
MFPPA	35	22.00	48.50	42.0057	5.05662	-1.859	6.124

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, lartësia e trupit (ALARTË) është 157.53 cm. Rezultati minimal (143.20 cm) dhe ai maksimal (165.00 cm) i ndryshorës lartësia e trupit tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të kësaj moshe në këtë

